



nr 1899 Prot, dt 16.12.25

Protokoll

Për zbatimin e *Marrëveshjes* së bashkëpunimit kërkimor shkencor dhe artistik ndërmjet Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (Për periudhën 2026-2027)

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (më tej: ASHAK) dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë (më tej: ASHSH), të quajtura në vijim *Palë*, me qëllim që të vazhdojnë të zhvillojnë traditën e bashkëpunimit të frytshëm kërkimor-shkencor mes tyre, pas bisedimeve dhe shkëmbimit të mendimeve për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërinstitucionale në përfundim të periudhës së protokollit për vitet 2024-2025, nënshkruajnë këtë *Protokoll bashkëpunimi* për periudhën 2026-2027, duke mbajtur parasysh rëndësinë e ndërmarrjes së nismave të përbashkëta shkencore nga të dyja *Palët*, të shkëmbimit të kërkuesve, përvojave dhe informacionit shkencor, mbështetur në *Marrëveshjen-kuadër* të nënshkruar ndërmjet tyre.

1. *Palët* bien dakord që veprimtaritë e përbashkëta të tyre për periudhën 2026-2027 (nisma shkencore, konferenca, botime, projekte); kalendari, vendi i zhvillimit dhe strukturat e ngarkuara për t'i ndjekur në zbatim të jenë si në pasqyrën në vijim:

Kuvende				
Nr.	Aktiviteti	Vendi	Koha	Përgjegjës
1.	<i>Kuvendi mbarëkombëtar dhe ndërkombëtar i albanologjisë</i>	Tiranë	2027	ASHSH - ASHAK
2.	<i>55- vjetori i Kongresit të Drejtshkrimit</i>	Tiranë	nëntor 2027	ASHSH - ASHAK
3.	<i>Kërkimet arkeologjike Shqipëri – Kosovë</i>	Tiranë		ASHSH - ASHAK
Konferenca shkencore ndërkombëtare				
4.	<i>"Të dhënat e shkencës së aplikuar në fizikë" (Shkolla Ballkanike, në Tiranë)</i>	Tiranë	Prill 2026	ASHSH- ASHAK
5.	<i>Ibrahim Rugova:</i>	Prishtinë	Maj, 2026	ASHAK-

	<i>shkrimtari, intelektual, presidenti</i>			ASHSH
6.	<i>Nanoteknologjia</i>	Tiranë	2026	ASHAK- ASHSH
7.	<i>Energjitë e rinovueshme</i>	Tiranë	2026	ASHSH- ASHAK
8.	<i>Konferenca e 4-të ndërkombëtare e shëndetit publik dhe mjedisit</i>	Prishtinë - Tirane	2026 - 2027	ASHAK- ASHSH
9.	<i>Resurset ujore dhe mjedisi- Konferenca III</i>	Prishtinë - Tirane	2026 - 2027	ASHAK- ASHSH
10.	<i>Damastioni dhe tiparet e qytetërimit dardan në shek. III-I p. Kr.</i>	Tiranë	2026-2027 maj - qershor	ASHSH- ASHAK
Konferenca shkencore kombëtare				
11.	<i>Konferencë shkencore : Hoxhë Kadri Prishtina dhe roli i komitetit "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës"</i>	Prishtinë	Prill 2026	ASHAK- ASHSH
12.	<i>Konferencë shkencore: Roli i gjyqësisë kushtetuese në Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë</i>	Prishtinë	2026	ASHAK- ASHSH
13.	<i>Transformimet e turizmit në Shqipëri, mundësitë dhe problematikat drejt zhvillimit të qëndrueshëm</i>	Tiranë	Qershor 2026	ASHSH - ASHAK
14.	<i>Shqiptarët në studimet e autorëve grekë</i>	Tiranë	Nëntor 2026	ASHSH - ASHAK
15.	<i>Bota dhe kultura arbëreshe sot</i>	Tiranë	nëntor 2026	ASHSH - ASHAK
16.	<i>Lidhjet transnacionale dhe ndërveprimi kulturor i politikës identitare dhe politikës shtetërore në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Kosovës</i>	Tiranë Prishtinë	2026	ASHSH- ASHAK
17.	<i>Për një terminologji gjuhësore shqipe bashkëkohore e funksionale</i>	Tiranë	2026	ASHSH - ASHAK

18.	<i>Konferenca e III-të shkencore për ekonominë</i>	Prishtinë	2027	ASHAK-ASHSH
Projekte madhore				
19.	<i>Enciklopedia shqiptare</i>	Tiranë-Prishtinë	2026-2027	ASHSH-ASHAK
Projekte				
20.	Projekte në kuadër të njësisë: nanoalb, gjeoshkencave, pasurive ujore, energjitë e rinovueshme, kërkimet gjeografike etj.	Tiranë-Prishtinë	2026-2027	ASHSH-ASHAK
21.	<i>Përcaktimi i kapaciteteve mbajtëse të ngarkesës turistike në peizazhet natyrore dhe sociale (rasti peizazhit të një siti bregdetar, malor e urban), duke përdorur teknologjitë e avancuara GIS dhe Dron</i>	Tiranë-Prishtinë	2026-2027	ASHSH-ASHAK
22.	<i>Studimi i ndryshimeve mjedisore me imazhe satelitore, përfundimi i studimit aktual dhe mundësisht shtrirja në zona të tjera</i>	Tiranë-Prishtinë	2026-2027	ASHSH-ASHAK
23.	<i>Mjedisi gjeografik në Shqipëri dhe Kosovë, qasje e bazuar në kompetenca dhe në kurrikulat e arsimit parauniversitar</i>	Tiranë-Prishtinë	2026-2027	ASHSH-ASHAK
24.	<i>Studim krahasues gjeografiko-urban të kryeqendrave të Tiranë dhe Prishtinë</i>	Tiranë-Prishtinë	2026-2027	ASHSH-ASHAK
25.	<i>Studim: Krijimi i kornizës së përbashkëta të vlerave të monumenteve të natyrës në Shqipëri dhe Kosovë - Ndërtimi i një skeme të përbashkët vlerësimi për</i>	Tiranë-Prishtinë	2026-2027	ASHSH-ASHAK

	<i>një të ardhme të qëndrueshme</i>			
26.	<i>Peizazhi shqiptar në shekuj</i>	Tiranë-Prishtinë	2026-2027	ASHSH-ASHAK
	Botime			
27.	<i>Botimi i studimeve të përbashkëta</i>	Tiranë-Prishtinë	2026-2027	ASHSH-ASHAK
28.	<i>Fjalor i Ekonomisë</i>	Tiranë-Prishtinë	2026-2027	ASHSH-ASHAK
	Veprimtari promovuese			
29.	<i>Identifikimi i fushave të interesit të përbashkët kërkimor në gjeoshkencë</i>	Tiranë	2026	ASHSH-ASHAK
30.	<i>Nxitja e bashkëpunimit për projekte të përbashkëta studimore në infrastrukturë, pasuri minerare, ekologji</i>	Prishtinë Tiranë	2026-2027	ASHAK-ASHSH
31.	<i>Bashkëpunim për ngritjen e qendrave kërkimore në fusha të reja: robotikë, inteligjencë artificiale, bioteknologji, nanoshkencë dhe energjetike</i>	Tiranë Prishtinë	2024-2025	ASHSH-ASHAK
32.	<i>Vazhdimi i punës për një platformë të përbashkët për një qasje të hapur në botimet dhe periodikët shkencorë</i>	Tiranë-Prishtinë	2026-2027	ASHSH-ASHAK
33.	<i>Bashkëpunim profesional ndërbibliotekar</i>	Tiranë-Prishtinë	2026-2027	ASHSH-ASHAK
34.	<i>- Shkëmbime reciproke të periodikëve dhe botimeve shkencore dhe artistike të Palëve; - Botime të ndërsjella e promovime</i>	Tiranë-Prishtinë	2026-2027	ASHSH-

	<i>të rezultateve kërkimore shkencore dhe artistike;</i> <i>- Katalogimi online i fondeve albanologjike;</i> <i>- Përgatitje dhe botim online të bibliografive vetjake të kërkuesve shkencore, përrurim i tyre;</i> <i>- Shkëmbim eksperience për digjitalizimin e informacionit shkencor</i>			ASHAK
Panairi i botimeve shkencore				
35.	<i>Panairi i botimeve shkencore dhe akademike shkencore</i>	Tiranë-Prishtinë	2026-2027	ASHSH-ASHAK
Veprimtari kulturore artistike				
36.	<i>Koncerte dhe ekspozita të përbashkëta me vepra të kompozitorëve dhe artistëve të Shqipërisë dhe Kosovës</i>	Tiranë-Prishtinë	2026-2027	ASHSH-ASHAK
Veprimtari përkujtimore/ceremoniale				
37.	<i>Nderimi i figurave kryesore shkencore dhe akademike të Palëve</i>	Tiranë-Prishtinë	2026-2027	ASHSH-ASHAK

2. Për çdonjëren prej veprimtarive të parashikuara *Palët* hartojnë dhe miratojnë programin e posaçëm shkencor të punës, që miratohet prej tyre në përputhje me procedurat që zbatojnë. Programi i punës propozohet nga *Pala pritëse* e veprimtarisë.
3. Veprimtaritë që përmban pasqyra më sipër *Palët* i përfshijnë në kalendarët vjetorë të punës së tyre.
4. Këtij *Protokolli* mund t'i bëhen shtesa dhe ndryshime gjatë procesit të zbatimit, varësisht prej dinamikës së përparësive dhe mundësive financiare të *Palëve*. Propozimet për shtesa a ndryshime bëhen me shkrim nga *Palët* dhe shqyrtohen për miratim brenda një periudhe tremujore. *Palët* bashkëpunojnë edhe jashtë zotimeve të këtij *Protokolli*.
5. Shpenzimet e udhëtimit në funksion të zbatimit të këtij *Protokolli* janë të *Palës udhëtuese*, kurse shpenzimet e akomodimit/fjetjes janë të *Palës pritëse*. Kjo është e vlefshme edhe për pjesëmarrjet në veprimtari shkencore, përveç rasteve kur merren vesh ndryshe.
6. Për të ndjekur ecurinë e realizimit të veprimtarive të parashikuara në këtë *Protokoll* përfaqësues të *Palëve* takohen të paktën një herë në vit, vendi dhe data e takimit caktohen

me marrëveshje rast pas rasti, me letërkëmbim.

7. *Protokolli* u nënshkrua në Tiranë, më 16.12.2025, në dy kopje, në gjuhën shqipe. Ky *Protokoll* hyn në fuqi më 1 janar 2026.

**Për Akademinë e Shkencave dhe të
Arteve të Kosovës**

Akad. Mehmet Kraja, Kryetar



**Për Akademinë e Shkencave
të Shqipërisë**

Akad. Skënder Gjinushi, Kryetar

